



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:140498

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05686500

C.nr.120/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. A. H. H. nga Lipjani, Rr. “H. J.” p/n, kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, të cilën e përfaqëson i autorizuari Ramadan Krasniqi nga Dragashi, me bazë juridike kompensimin e shujtave ditore gjatë punës, udhëtimit dhe kompensimi i diferencës së pagesës sipas kualifikimit - Licencës, vlera e kontestit 2,475.90 €, jashtë shqyrtimi, me dt. 15.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. A. H. H. nga Lipjani.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Dragash, që paditësit D. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit, në emër të kompensimit të shujtave gjatë punës për ditët e pranisë në punë për 302 ditë pune, nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur prej dates 01.01.2019 deri me datën 31.12.2021, t’ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej **604.00 € (gjashtëqind e katër euro)**, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 302 ditë nga $0.50+0.50=1.00 \times 70\% = 0.70$ Euro **shumën prej 211.40 euro**, si dhe në emër të diferencës së pagesës sipas Kualifikimit – Licencës, dhe atë 27% nga paga bazë $421 \text{ €} \times 0.27\% = 113.67-58.32$ diferenca = $55.35 \text{ €} \times 30$ muaj, për periudhën nga data 15.06.2018 e deri me datën 21.01.2021 për 30 muaj **t’ia paguaj shumën prej 1.660,50 euro e gjithsejtë shumën prej 2,475.90 € (dymijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë centi)**, me kamat ligjore duke llogaritur në lartësi 8%, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 394,40 euro.

A r s y e t i m

Paditësi D. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përmes përfaqësuesit të autorizuar pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi me 30.06.2021, kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale në Dragash, për kompensimin e shpenzimit të ushqimit gjatë ditës (shujtave ditore), pagesën e shpenzimeve të transportit si dhe kompensimin e diferencës së pagesës sipas

kualifikimit – Licencës, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 19.12.2023, **ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:**

Paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët (tutje: SHFMU) “.. N.” në fshatin..., Komuna e Dragashit në pozitën e Mësimdhënësit të Biologjisë që nga viti 2002 e deri tani. Tutje, ka theksuar se e paditura Komuna e Dragashit përkundër obligimeve dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017, konform dispozitave të nenit 35 pika 7 e kësaj marrëveshjeje, nuk ka bërë kompensimin e shujtave ditore dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, kurse për çdo ditë pune udhëton nga vendbanimi i tij për në vendin e punës ndërsa në bazë të të nenit 35.5 të KKAP të dt. 18.04.2017 i takon kompensimi në emër të shpenzimeve të udhëtimit nga 70% të biletës së trafikut publik. Ndërsa nga e njëjta bazë e në kuptim të nenit 7 par. 1.3 të KKAK-së të dt. 18.04.2017, paditësit i takon edhe kompensimi i pagesës në emër të kualifikimit dhe atë për 27% të pagës bazë, duke propozuar gjykatës aprovimin padisë dhe detyrimin e të paditurës që të bëjë pagesën e shpenzimeve të ushqimit si dhe diferencën e pagesës sipas kualifikimit – licencës.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar përmes parashtresës së datës 15.04.2024.

E paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar ka parashtruar përgjigjen në padi përmes parashtresës së datës 14.06.2022 duke e kontestuar në tërësi padinë e paditësit, me arsyetimin se Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 i ka kaluar afati dhe nuk ka bazë ligjore dhe nuk prodhonë efekt juridik, edhe atë duke u bazuar në ligjin e punës afati i kontratës kolektive ka zbatim 3 vjet. Mbi bazën e tillë i ka propozuar gjykatës refuzimin e padisë si jo të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata edhe pse ka mbajtur dhe ka caktuar seancën përgatitore (datë 27.04.2023) dhe seancën e parë të shqyrtimit kryesorë (me datë 10.10.2023), duke parë mos kompleksitetin e lëndës dhe veçanërishtë edhe praktikën gjyqësore të krijuar rreth këtyre lëndëve por gjithashtu edhe parimit të efikasiteti dhe ekonomizimit të procedurës paraparë me dispozita procedurale, përmes Aktvendimit të dt. 30.11.2023 i ka derguar paditësit padinë në plotësim dhe precizim të petiutimit të padisë, veprim të cilën përfaqësuesi i paditësit e ka bërë përmes parashtresës së datës 19.12.2023.

E paditura edhe pse ka pranuar parashtresën e paditësit rreth plotësimit dhe precizimit të padisë me datë 15.01.2024 e njëjta nuk ka paraqitur kundërshtime rreth saj.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve, gjykata ka administruar provat: ka lexuar kontratën Nr.220/2018 të dt. 06.09.2018, Vërtetimin Nr.75/2021 e dt. 14.06.2021, Diploma Nr.1137 e dt. 20.09.2010, Licenca Nr.10001... e lëshuar nga MASHT, Lista e pagave në emër të paditësit, Certifikata e vendbanimit Nr.B 10510129 e dt. 18.12.2023, kuponi fiskal lëshuar nga N.T.N. “B. Tours” i dt. 18.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar** nga arsyet e cekura si më poshtë:

Nga Listat e pagave në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro.

Nga Kontratat e punës në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura në kohë të pacaktuar dhe me kontratë I.

Nga Diploma Bachelor Nr.1137 e dt. 20.09.2010 në emër të D. (N.) S., gjykata vërtetoi faktin se paditësi me datë 06.07.2000, i ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore dhe ka marrë titullin “Profesor i Biologjisë”.

Nga Licenca e mësimdhënësit Nr.100010473, gjykata vërtetoi faktin se paditësi, është pajisur me licencë të karrierës nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë edhe atë për periudhën nga data 01.03.2013 e deri më 01.03.2018.

Nga administrimi i Vërtetimit mbi stazhin e punës lëshuar nga SHFMU “.. N.” në fshatin B. Nr.75/2021 e datës 14.06.2021, gjykata vërteton se paditësi D. S. është punëtorë e kësaj shkollë nga viti shkollor 2002/2003 dhe në vazhdimësi nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2019 ka punuar në këtë shkollë 185 ditë, nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020 ka punuar 117 ditë dhe nga data 01.01.2021 deri më 18.04.2021 ka punuar 111 ditë.

Nga administrimi i Certifikatës së vendbanimit Nr.B 10510129 e dt. 18.12.2023, gjykata provonë faktin se paditësi banon në fshatin Z., Komuna Dragash.

Nga shiqimi i kuponit fiskal lëshuar nga N.T.N. “B. Tours” i dt. 18.12.2023, nga gjykata provohet shuma prej 0.50 centi që është paguar për bilet.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe neni 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura në cilësinë e mësimdhënësit (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr. prot. 220/2018, dt. 06.09.2018 dhe vërtetimi me nr. 75/21 dt.14.06.2021); nuk është kontestues fakti se i njëjti është me kualifikim shkollor fakultet (fakti vërtetuar nga diploma me nr.1137 dt.20.09.2010 dhe licenca e mësimdhënësit me nr. 100010473); paga bazë e tij është 421.00 euro, ndërsa për kualifikim paguhet në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar nga lista e pagave lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës) si dhe fakti që i njëjti nga data 01.01.2019 e deri me datën 31.12.2021 ka gjithsejtë 302 ditë pune (fakt i vërtetuar në bazë të Vërtetimit Nr.75/2021 të dt. 14.06.2021) por edhe faktin se ai për transport deri në vendin e tij të punës nga vendbanimi i tij në fshatin Z. deri në SHFMU “... N.” në fshatin..., shfrytëzon transportin publik.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve

profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, prova në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjithashtu sa i përket të drejtës për pagesë e shujtave, në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 (dhe asaj pasuese e datës 22.01.2021) me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”*. Së këndejmi, rezulton se punëdhënësi i paditësit është e paditura në këtë rast, Komuna e Dragashit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Ndërsa, sipas nenit 2 par. 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë shprehimisht precizohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*. Andaj, mbi bazën e kësaj që u paraqit, sipas raportit juridik të paditësit me të paditurën, këtë të fundit e bën plotësisht legjitime dhe me kompetencë për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm bazën e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit e aprovuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se *“I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*; nenit 90, paragrafi 5 se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dates 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”*;

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017– 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Meqë e paditura ka kontestuar afatshmërinë e padisë, gjykata ka gjetur se paditësi ka paraqitur kërkesën (padinë) më dt. 30.06.2021, ndërsa kompensimin sa i përket shujtave e ka kërkuar nga viti 2019 e deri më 31.12.2021. Bazuar në nenin 7 të Ligjit të Punës që përcakton se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga*

dita e paraqitjes së kërkesës”, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka pasur të drejtë të parashtrojë kërkesën duke llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e paraqitjes së saj.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me fakultet, pasi është paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, me ç’rast i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro. Nga kjo arsye, detyroi të paditurën t’ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të kualifikimit shkollor – përkatësisht diferencën e papaguar për muajt e punës sa i përket periudhës 15.06.2018 – 21.01.2021 edhe atë për 30 muaj nga 55.35 euro apo gjithsejtë shumën për diferencën e pagesës – Licencës prej 1,660.50 euro.

Gjykata gjithashtu shqyrtoj edhe aspektin e afatit të licencës së paditësit – mësimdhënësit, e cila licencë ka qenë me afat prej pesë (5) vitësh edhe atë deri më 01.03.2018 dhe të njëjtën e vlerësoj se është në harmoni me UA Nr.05/2017 për Sistemin e e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë e ku thuhet se: *“Vazhdohen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014...”* (neni 33 par.1 pika 1.1 të UA-së nr.05/2017), faktë ky që dëshmon se këto licenca janë valide deri më 01.03.2025.

Ndërsa sa i përket shujtave gjykata ka vlerësuar se nga data 01.01.2019 – 31.12.2021 sa edhe ka qenë kërkesa e paditësit për ditet e pranisë në punë, për gjithsejt 302 ditë pune nga dy (2) euro për një ditë, t’i paguaj shumën prej 604 euro për shujta dhe si i tillë një vlerësim për gjykatën ka qenë i thjeshtë dhe për këtë arsye edhe nuk ka nagazhuar ekspertizë përkatëse financiare duke synuar parasëgjithash ekonomizimin e procedurës.

Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, gjykata vlerëson se Vendimi i Qeverisë nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Prej beneficioneve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit është gjithashtu edhe pagesa e shpenzimeve të rrugës (transportit), konstatim i dalë nga neni 35.5 e Kontrates Kolektive të Arsimit në Kosovë, citojmë: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut publik”*. Nga provat e administruara është provuar që vendbanimi i paditësit është në fshatin Z. ndërsa vendi i tij i punës është në SHFMU “... N.” në fshatin B., ndërsa për transport publik shfrytëzon transportin urban (autobusin), ku bileta për një drejtim është 0.50 centi ndërsa ditore 1.00 euro x 70% = 0.70 euro për 302 ditë apo shuma totale prej 211.40 euro.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, për përpilimin e padisë shumën 104.00 euro për taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 euro si dhe për dy seanca gjyqësore të mbajtura nga 135,20 apo shumën totale prej 394,40 euro.

Ndërsa sa i përket shumës prej 104.00 euro, për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë, gjykata e refuzoi në tërësi nga fakti se përfaqësuesja e paditësit me fajin e saj, përmes padisë fillestare nuk e ka paraqitur padinë e rregullt dhe të plotë konform nenit 99 dhe 253 të LPK-së. Kurse për 20 euro rreth takses për padi, gjykata nuk ka prova që janë paguar 40 euro taksa por vetëm 20 euro edhe atë në bazë të Urdhërpagesës të dt. 22.06.2021.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:140498, 15.05.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.